Pozicion i lirë: Inxhinier servisi për pajisjet laboratorike

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Instalon, mirëmban, riparon dhe jep mbështetje teknike për pajisjet biomjekësore.
- Kryen testimet e nevojshme, siguron përputhshmërinë me parametrat, duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit. Realizon kalibrimet periodike të pajisjeve sipas planit të paracaktuar.
- Përshtat hardware ose software për përdorimin e tyre në pajisje të ndryshme biomjekësore.
- Ka përgjegjësi për diagnostikimin dhe interpretimin e të dhënave bioelektrike, duke përdorur teknika të përpunimit të sinjalit.
- Marrja e informacioneve nga servis-manualet përkatëse sipas aparateve dhe realizimi i zgjidhjes së problemeve.
- Ndjek riparimin në kohë për pajisjet të cilat janë në mirëmbajtje me palë të treta.
- Bën kontrollin/instalimin e pajisjeve të reja nësë janë brenda standardeve apo parametrave. Realizon përditësimet software-ike të pajisjeve mjekësore.

Kriteret e nevojshme:

- Diplomë në Inxhinieri, dega Mekatronikë përbën avantazh.
- 2 vjet eksperiencë në këtë profil ose punë të ngjashme.
- Njohje shumë të mirë të pajisjeve kompjuterike.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës Angleze.
- Aftësi për të punuar në grup.

Mund të aplikoni duke dërguar Cv tuaj në adresën e emailit: hr@evitaalbania.com

Afati i fundit i aplikimeve: 01.04.2022

Do të kontaktohen vetëm kanditatët që do të përzgjidhen për fazën e parë!